



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.4.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
ISTOGUT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Istogut në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (udhëheqësi i ekipit) dhe Edon Kabashi (anëtar).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	29
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	32


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Istogut për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ne dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre të dhënë gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrave Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 02.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse pasuritë komunale ishin nënvlerësuar si rezultat i mos regjistrimit të 1540 parcelave komunale në regjistrin kontabël. Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 183,120€, si dhe pagesat nga palët e treta në vlerë prej 490,000€ nuk ishin regjistruara në SIMFK.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi te nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontrollit të brendshëm në nivelin e tanishëm nuk ofron sigurinë se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen në mënyrë efektive, dhe si i tillë, ka nevojë për një mbikëqyrje të shtuar dhe përmirësim në disa fusha.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Dhënia me qira e pronës komunale (tokës bujqësore) nuk ishte bërë përmes ankandeve publike



Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandeve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale, në mënyrë që ketë një proces të hapur dhe transparent (shih çështjen 12)

Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E ISTOGUT

OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31.12.2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të Pasqyrave Vjetore Financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme); Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në

pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, pasi që procesi i regjistrimit ende nuk është përfunduar. Janë identifikuar 1540 parcela të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël.

Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për 183,120€ për shkak se ato nuk ishin përfshirë në PVF.

Komuna kishte prezantuar në PVF pagesa nga palët e treta shumë 490,000€ si pagesa direkte të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në SIMFK. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Personat e ngarkuar me qeverisje, si: Kryetari i Komunës, drejtorët dhe zyrtarët financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 02.10.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të që ndërlidhen me keq klasifikimin e shpenzimit dhe mos regjistrimin e duhur të pasurive. Këto janë rreziqe të keq pohimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes

Rreziku i mos regjistrimit të pasurive komunale ka ndodhur për shkak se 1540 parcela komunale nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël.

Rreziku i keq klasifikimit të shpenzimeve ka ndodhur sepse komuna gjatë vitit kishte paguar 60,302€ nga kategoria e investimeve kapitale sipas marrëveshjes Caritas Kosova për ofrimin e shërbimeve.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese për PVF dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal;
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€; dhe
- Pasqyrat nëntëmujore financiare.

Sa i përket kërkesave më lartë, komuna i kishte trajtuar dhe është në pajtim me kornizën raportuese.

Në kontekstin e cilësisë së informatave PVF përmbajnë disa gabime dhe mangësi informatash ku po i paraqesim në vijim:

- Te neni 12 pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme, te shtylla e dytë shënimi 4 pagesat nga palët e treta, komuna kishte prezantuar shumën 490,000€ të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në sistem të thesarit si pagesa direkte;
- Te neni 13 raporti i ekzekutimit të buxhetit- te pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit tek shtylla buxheti fillestar shënimi 17 donacionet, komuna kishte prezantuar gabimisht shumën 6,000€ ndërsa ishte dashur të jetë 0;
- Te neni 13 raporti i ekzekutimit të buxhetit- te pjesa e hyrjes së parasë së gatshme në llogari të thesarit tek shtylla e realizimit shënimi 17 donacionet, komuna kishte prezantuar shumën 39,000€, ndërsa sipas shënimeve të Free balancit është dashur të jetë 33,264€, pra ekziston një diferencë prej 6,264€;
- Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve, ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar 60,320€, për paga dhe mëditje për punëtorët e angazhuar në QKMF duke u bazuar në marrëveshjen që kishte lidhur me Caritas Kosovën për kryerjen e shërbimeve të parapara me projektin 'Përkujdesja Shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore'.
- Vlen të sqarohet se shuma prej 60,320€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.
- Te shënimi 32 përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës, komuna i kishte prezantuar vetëm stoqet e administratës në vlerë prej 5,000€, ndërsa ato të shëndetësisë dhe arsimit nuk ishin prezantuar;
- Te shënimi 31 përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1,000€ dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit komuna kishte prezantuar vetëm blerjet që janë bërë gjatë vitit 2015 prej 20,000€. Sipas raportit të e-pasurisë ato duhet të jenë 97,318€; dhe
- Shënimi 34 Të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për 183,120€.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënëse për keq klasifikim të shpenzimeve dhe pasuritë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve, siç janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston nevoja për përmirësime të mëtejme në proceset e qeverisjes, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimit menaxherial dhe sistemin auditimit të brendshëm. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar me 16 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi me zotimin se rekomandimet e dhëna do të adresohen.

Deri fund të periudhës së auditimit, tri (3) rekomandime ishte adresuar plotësisht, shtatë (7) janë në proces të implementimit, dhe gjashtë (6) të tjera nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

Raporti i auditimit për PVF e vitit 2014 ishte diskutuar në Kuvendin Komunal me datën 09.09.2015, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të komunës.

Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Si të tilla, në këtë raport përsëri janë ngritur çështje për përmirësim në fusha të caktuara.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- pagesat nga kodet jo adekuate ekonomike;
- mos raportim të obligimeve të papaguara sipas kërkesave ligjore; dhe
- mungesa e organizmit të ankandëve me rastin e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave (MF) ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF nga ana e komunës, dhe kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do ta japë gjendjen për një numër të çështjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar disa çështje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentat përbërëse. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. Komuna nuk ka strategji për zhvillim ekonomik lokal;
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga komuna;
4. Auditimi i Brendshëm nuk i ka trajtuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2015 është i limituar, dhe kjo është trajtuar në hollësi në kapitullin 2.6;
5. Forma e raportimit që bëhet tek kryetari bëhet sipas nevojës, dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta mbi punët dhe aktivitetet e tyre (për më shumë shih nënkapitullin 2.5.2).

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave. Gjithashtu, raportimi dhe komunikimi do të përmirësojnë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave eventuale.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat ajo përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik të komunës.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit të plotësuar ka vërtetuar se komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.
- Rreziku** Mungesa e një procedure formale dhe të dokumentuar e rreziqeve në organizatë, do të zvogëlojë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj rreziqeve potenciale dhe për të reduktuar rreziqet në nivel të pranueshëm.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se rreziqet do të identifikohen përmes një regjistri, ku do të vlerësohet niveli i rrezikut, gjasat që rreziqet të ndodhin si dhe masat adekuate si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve. Më tej, një zyrtar i lartë i komunës duhet të përkujdeset për zbatimin dhe monitorimin sistematik.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Dobësi në Kontrollat Menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës, ne kemi vërejtur dobësi evidente në raportim. Forma e raportimit që bëhet tek kryetari bëhet sipas nevojës, dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta mbi punët dhe aktivitetet e tyre. Për arsytet e përmendura, ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë tek disa kategori ekonomike, si: të hyrat, mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale, subvencione dhe transfere.
- Rreziku** Raportimi jo i rregullt nga ana e drejtorive tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me drejtorin e kësaj njësie. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera, dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv Auditimi.

Çështja 5 – Funkcionimi i NJAB dhe komitetit të auditimit – Prioriteti i lartë

E gjetura NJAB-i për vitin 2015 kishte planifikuar të kryej katër auditime, prej të cilave tri i kishte përfunduar.

Auditimet e kryera kishin mbuluar këto fusha: Tatimi në pronë (fushëveprimi 2015), menaxhimi i pasurisë (fushëveprimi 2014 dhe Janar-Qershor 2015), dhe procesi i prokurimit që kishte mbuluar vitin 2014.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime, ku në bazë të procesverbaleve të mbajtura theksohet se kishte diskutuar raportet e NJAB dhe të ZAP. Më tutje, nevojitet një punë më cilësore dhe më e theksuar e komitetit në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se menaxhmenti i kishte implementuar pjesërisht rekomandimet të dhëna nga NJAB-i.

Rreziku Neglizhenca e menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB rritë rrezikun që dobësitë e identifikuara të përsëriten. Ndjekja e ngjarjeve nga auditimi pasi ato të kenë ndodhur, nuk i shton vlerë përmirësimit të operacioneve dhe parandalimit të gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të diskutoj një plan veprimi me nivelet tjera menaxhuese dhe të përcaktoj stafin përgjegjës dhe afatet për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm. Një proces monitorimi mbi progresin, gjithashtu duhet të vendoset. Në identifikimin e çështjeve për trajtim, NJAB duhet të fokusohet më shumë në aktivitetet e vitit aktual, me prioritet në fushat ku rreziku vlerësohet i nivelit të lartë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet ende fushë që kërkon përmirësime, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët për para. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale, menaxhimi i pasurive, si dhe vendosja e kriterëve të matshme me rastin e subvencionimit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimet	2014 Shpenzimet	2013 Shpenzimet
Burimet e Fondeve:	8,578,023	9,212,022	8,878,415	8,176,752	8,339,097
Granti i Qeverisë - Buxheti	7,563,874	7,747,241	7,711,699	7,420,977	7,406,811
Të bartura nga viti paraprak ²	-	411,741	391,906	106,245	144,464
Të hyrat vetjake ³	1,014,149	1,014,149	742,835	606,985	683,436
Donacionet e brendshme	-	38,891	31,975	24,465	48,789
Donacionet e jashtme	-		0	18,080	55,597

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 633,999€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë për pagesën e përvojës së punës në shumë 183,367€, për të hyrat e bartura me vlerë prej 411,741€ si dhe donacioneve të brendshme me vlerë 38,891€.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual të përdorura për vetëfinancim.

Në vitin 2015 komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final, për afërsisht në shkallë të njëjtë me vitin e kaluar (94%). Në përgjithësi, kjo mund të konsiderohet një performancë mjaft e mirë e ekzekutimit buxhetor.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,578,023	9,212,022	8,878,415	8,176,752	8,339,097
Pagat dhe Mëditjet	5,340,000	5,523,366	5,519,858	5,046,011	4,318,168
Mallrat dhe Shërbimet	793,435	887,821	810,343	629,647	864,385
Shërbimet komunale	135,338	161,835	161,046	126,008	187,559
Subvencionet dhe Transferet	272,250	394,641	327,545	168,359	359,903
Investimet Kapitale	2,037,000	2,244,359	2,059,623	2,206,727	2,609,082

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Ndryshimi tek kategoria e pagave dhe mëditjeve prej buxhetit fillestarë në atë final është 183,366€, kjo për arsye se Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për pagesën e përvojës së punës;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi rritje të buxhetit final në krahasim me atë fillestar për 94,386€. Kjo rritje është rezultat i hyrave vetjake të bartura nga viti i kaluar;
- Si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, tek kategoria e Subvencioneve kishte rritje të buxhetit final në raport me atë fillestar për 122,391€; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale, ka pasur gjithashtu rritje të buxhetit final për 207,359€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura prej 168,468€ dhe donacioneve të brendshme 38,891€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake të komunës – pranimit ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,014,149	1,014,149	941,133	936,047	683,436

Të hyrat vetjake vjetore gjatë vitit 2015 ishin realizuar 93% nga shuma e planifikuar, që mund të konsiderohet si një normë mjaft e lartë e inkasimit.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet e prokurimit gjatë vitit ishin 2.1 milionë euro. Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në projektet e parapara për tu realizuar gjatë vitit. Vlerësimet tona janë se nuk ka ndonjë çështje për t'u ngritur në këtë raport.

Ne gjithashtu kemi bërë edhe vlerësimin e zbatimit të procedurave dhe testet tona kanë identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 6 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura

Sipas nenit 81 të LPP dhe nenit 55 të Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, autoriteti kontraktues duhet të hartoj një plan për menaxhim të kontratës. Ne kemi identifikuar se për kontratat e nënshkruara për mallra dhe shërbime nuk ishte përgatitur ndonjë plan për menaxhimin e kontratave.

Sipas UA nr. 1/2014 Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Ne kemi vërejtur se në 4 raste komuna kishte nënshkruar kontrata për punë pa projekte ekzekutive.

Në kontratën “Hartimi i planit komunal për eficiencën e energjisë 2014-2020” në vlerë 5,850€, nuk ishin zhvilluar procedura të prokurimit. Ky shërbim ishte kontraktuar në mes të komunës dhe operatorit ekonomik sipas një marrëveshje që kishte lidhur kryetari me operatorin ekonomik.

Në kontratën “Rrënimi i objektit Radusha në Istog” në vlerë 9,829€ nuk ishin zhvilluar procedura të prokurimit. Ky shërbim ishte kontraktuar në mes të komunës dhe operatorit ekonomik sipas një marrëveshje që kishte lidhur drejtori i shërbimeve publike me operatorin ekonomik.

Rreziku Rastet e mësipërme tregojnë për dobësi në procesin e prokurimit. Prania e dukurive të tilla gjatë planifikimit dhe ekzekutimit nuk është në pajtim me rregullat e prokurimit.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë, duke mos i anashkaluar procedurat e prokurimit, si dhe të hartohen projektet specifike para se të fillojnë procedurat e prokurimit.

Çështja 7 - Dobësitë jo sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Në kontratën kornizë dy vjeçare “Fshirja dhe larja e rrugëve dhe trotuareve në rrugët e zonave urbane në Istog”, vlera e përafërt një vjeçare e kontratës është rreth 25,000€, kontrata ishte dhënë ofertuesit të papërgjegjshëm i cili nuk kishte nënshkruar dhe vulosur formularin për dorëzimin e tenderit. Komisioni i vlerësimit të tenderëve e kishte vlerësuar të përgjegjshëm operatorin fitues.

Në kontratën “Furnizimi me thëngjill për Institucionet Komunale të Istogut” Lot-I-, në vlerë të parashikuar 25,000€, komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorin me çmimin prej 57.85 €/tonë, ndërsa kishte eliminuar operatorin ekonomik që kishte ofertuar me çmimin prej 36€/tonë, edhe pse të dy ofertuesit ishin të përgjegjshëm para komisionit për vlerësimin e tenderëve.

Në kontratën “Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Cerrcë - Lubozhdë” në vlerë 91,654€, ofertuesi edhe pse i kishte përmbushur kriteret në dosje të tenderit, para lidhjes së kontratës zyra e prokurimit kishte kërkuar vërtetimin nga administrata tatimore e Kosovës se nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, përderisa sipas vërtetimit tatimor fituesi i tenderit ishte në marrëveshje me Administratën Tatimore të Kosovës për të shlyer borxhet tatimore të mbetura me këste. Kontrata ishte lidhur në mes të Komunës së Istogut dhe fituesit të tenderit i cili ishte i papërgjegjshëm, gjë që është në kundërshtim me LPP-në përkatësisht neni 65 pika 4.8.

Rreziku Mos zbatimi i kriterëve të vendosura në dosjen e tenderëve ndikon që fituesi i tenderit të mos zgjidhet në mënyrë adekuate, dëmton konkurrencën dhe transparencën e procesit, dhe rrjedhimisht të kontraktohen mallrat, punët apo shërbimet me çmime më të shtrenjta se çmimet e tregut..

Rekomandimi 8 Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar në rastet e mësipërme dhe të implementohen kontrole të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëritet në të ardhmen.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Tek shpenzimet pa prokurim, kemi identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 8 - Pagesat sipas marrëveshjes si dhe kontrata për shërbime të veçanta - Prioritet i lartë

E gjetura Me datën 04.02.2015 kryetari kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Caritas Kosova për projektin “Përkujdesja Shëndetësore shtëpiake dhe ambulatorë - Home Care-2015” në vlerë 92,130€. Me këtë marrëveshje komuna obligohet të participoj shumën 61,970€ për periudhën shkurt-dhjetor 2015, ndërsa Caritas Kosova duhet të participoj me 30,160€. Komuna kishte paguar shumën prej 31,000€ në muajin mars, ndërsa pjesën tjetër e kishte paguar në muajin korrik 30,970€, duke u bazuar vetëm në marrëveshjen e lidhur pa fatura dhe pa raporte periodike që konfirmon nëse punët apo mallrat dhe shërbimet janë pranuar. Caritas Kosova ka dorëzuar një raport përmbledhës për aktivitetet e kryera, por raporti nuk është i detajizuar me të gjitha informatat. Këto mjete komuna i kishte paguar nga kategoria ekonomike e Investimeve kapitale kodi ekonomik 33200 Transfere kapitale. Për pjesën që ka qenë i zotuar donatori të investoj (30,160€), komuna nuk ka të dhëna nëse me të vërtetë donatori i ka investuar sipas marrëveshjes.

Më tej, komuna ka të punësuar punëtorë me kontrata për shërbime të veçanta. Ne kemi identifikuar se 17 kontrata kanë kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj e ndër to kishte edhe kontrata të lidhura që nga viti 2010. Sipas nenit 12 pika 4 të Ligjit për shërbyesit civil, kontratat për shërbime të veçanta mund të lidhen për një periudhe më të shkurtër se 6 muaj.

Rreziku Nuk është e qartë pse komuna iu nënshtrohet kushteve të tilla të marrëveshjes që pagesat të kryhen disa muaj para se të fillon realizimi i projekteve. Kjo situatë përmban një shkallë të lartë rreziku që pagesat të kryhen, ndërsa projektet të mos realizohen.

Ripërtëritja e kontratave për shërbime të veçanta rritë rrezikun që shërbimet e tilla të mos jenë reale me nevojat e komunës dhe që buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar. Për më tepër, mund të punësohet stafi jo kompetent dhe shërbimet e ofruara të mos jenë cilësore.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikrat e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimit të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie., Më tutje, kontratat për shërbime të veçanta të përdoren për qëllime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 6 muaj siç e përcakton ligji. Ne sugjerojmë që praktikrat e tilla të mos përsëriten.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 5,523,366€, ndërsa shpenzimet 5,519,858€ apo 99%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për anëtarët e Kuvendit Komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës, dhe nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për ta ngritur, përveç rastit të paraqitur më poshtë;

Çështja 9 - Mos harmonizim i pozitave të punës në mes kontratave dhe listës së pagave - Prioritet i mesëm

E gjetura Rekomandimi jonë i dhënë në raportin e auditimit për mos harmonizimin e 16 pozitave të punës sipas kontratave dhe listës së pagave ende nuk është implementuar. Pra, që nga viti 2010 komuna ka në listën e pagave 16 udhëheqës të personelit, ndërsa realisht me kontratë ka vetëm një udhëheqës të personelit, kurse të tjerët me kontrata të punës janë: certifikues, shpenzues, udhëheqës sektorësh, koordinator për barazi gjinore, etj. Kjo kishte ndodhur për shkak se drejtorët e drejtorive komunale në vitin 2010 kishin marr vendime për ngritjen e koeficienteve nga 7.5 në 9.5 për 16 punonjës.

Rreziku Rritja e koeficienteve për 16 punonjës krijon një pakënaqësi në mes të punëtorëve në administratën komunale. Ngritja e koeficienteve nuk është kompetencë e drejtorëve të drejtorive komunale dhe anashkalon përgjegjësitë e Kryetarit në marrjen e vendimeve (neni 13 i ligjit për vetëqeverisje lokale e autorizon se vetëm kryetari ka të drejtë të marr vendime apo urdhëresa të caktuara).

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të rishikoj çështjen e pse këto parregullsi në proces kanë ndodhur dhe po përsëriten vite me radhë, dhe të siguroj që në sistemin e pagave nuk do të procedohen pagesa në bazë të kontratave fiktive.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Në vitin 2015 komuna ka bërë ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike. Nga kjo kategori kemi testuar pagesat dhe kemi rishikuar nëse këto janë bërë në përputhje me rregulloren e ndarjes të subvencioneve. Disa nga mangësitë janë prezantuar më poshtë:

Çështja 10 – Mungesa e dëshmime me rastin e përzgjedhjes së përfituesve - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna kishte subvencionuar ndërtimin e serrave individuale me vlerë 60,000€, ku kishin aplikuar 303 fermerë. Sipas raportit të komisionit, 90% prej tyre i kishin plotësuar kriteret e vendosura me konkurs, ndërsa kanë përfituar 93 fermerë. Neve nuk na janë ofruar dëshmi se si janë përzgjedhë këta 93 përfitues në mesin e 303 aplikuesve.

Rreziku Mungesa e caktimit të kriterëve të qarta dhe të matshme rrit rrezikun që komuna me rastin e përzgjedhjes së përfituesve nuk do ta bëjë përzgjedhjen e duhur.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e subvencionimit të fermerve do të zbatohet një procesobjektiv dhe transparent, i bazuar në kriterë të qarta dhe matshme.

3.6 Të Hyrat vetjake

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin 941,133€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë; Taksa për regjistrimin e automjeteve, Lejet e ndërtimit, Të hyrat nga taksa administrative, etj.

Çështja 11 – Tatimi në pronë – Prioritet i lartë

E gjetura Sipas ligjit të buxhetit të Kosovës për vitin 2015 tek tabelat 4.3 Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal përcakton se komuna e Istogut nga tatimi në pronë kishte planifikuar që të realizoj shumën 695,628€, ndërsa sipas shënimeve të komunës planifikimi i të hyrave për këtë llogari është 295,009€, pra kemi jo konsistencë në mes planifikimit sipas buxhetit dhe atij sipas shënimeve të komunës. Gjatë vitit ishin faturuar 10,410 obligues tatimor me një ngarkesë prej 332,806€, ndërsa realizimi nga kjo llogari është 292,128€. Ne kemi testuar shtatë mostra nga tatimi në pronë dhe nga kjo kemi vërejtur se borxhe për vitin 2015 për mostrat e përzgjedhura janë me vlerë prej 9,963€. Borxhet total i akumuluar deri në fund të vitit 2015 për tatimin në pronë ishte 903,431€.

Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, si kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me të dhëna, sepse ka pasur mungesa të zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.

Sipas Ligjit mbi tatimin në pronë neni 9 ku ceket se çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej dhjetëmijë (10,000€) nga vlera e tatueshme e pronës. Ne kemi identifikuar se në gjashtë raste komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesorë dhe për secilën pronë ju kishte aplikuar zbritja prej 10,000€.

Rreziku

Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.

Çështja 12 - Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale - Prioritet i lartë

E gjetura

Komuna e Istogut kishte dhënë me qira pronat komunale (tokat bujqësore) 49 shfrytëzuesve në sipërfaqe 365 hektarë (ha), çmimi për 1 ha ishte nga 30€. Neve nuk na është ofruar dëshmi se si është caktuar kjo tarifë. Po ashtu, komuna nuk kishte organizuar ankande publike për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone siç kërkohet me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Po ashtu, ne kemi testuar 6 mostra të dhënies me qira të pronës komunale dhe kemi identifikuar këto dobësi:

Komuna kishte formuar një komision që t'i identifikoj të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike para lokaleve. Ky komision kishte konstatuar rreth 73 subjekte afariste që e shfrytëzojnë këtë hapësirë. Sipas rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba ishte dashur që shfrytëzuesit t'i paguajnë komunës shumën 3,453€, mirëpo vetëm 13 shfrytëzues i janë përgjigjur shkresës për pagesë duke i kryer obligimet ndaj komunës në shumë 477€. Komuna nuk kishte ndërmarr masa për t'i obliguar edhe shfrytëzuesit tjerë që t'i kryejnë obligimet e tyre.

Rreziku Dhënia e tokës komunale me qira pa organizuar ankand publik paraqet rrezik të zgjedhjes së gabuar, duke e kufizuar ofertën e tregut dhe dëmton parimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë për të gjithë të interesuarit. Po ashtu, shfrytëzimi i hapësirave publike pa kryer obligimet që dalin nga rregullorja komunale për taksa dhe ngarkesa, rritë rrezikun që inkasimi i detyrimeve të mbetura të vijë në pikëpyetje apo edhe të mos inkasohen fare. Kjo mund t'i shkaktoj komunës humbje të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandëve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale, në mënyrë që ketë një proces të hapur dhe transparent, si dhe të shtojë mekanizmat si dhe të ushtroj monitorim të vazhdueshëm tek shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë që ato të mos shfrytëzohen pa kryer paraprakisht obligimet sipas rregullores komunale.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Në vitin 2014 vlera neto e pasurive në regjistrin kontabël ishte 12,262,984€, ndërsa në vitin 2015 kjo vlerë ishte rritur në 13,928,994€. Siç shihet, komuna ka vazhduar me procesin e regjistrimit të pasurive dhe ka bërë një progres të lehtë në vitin 2015, por deri në kompletimin e një regjistri përfundimtar të pasurive mbetet edhe shumë për t'u bërë.

Çështja 13 - Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren e menaxhimit të pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk ka procedura të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin pasurisë 02/2013.

Komuna ka arritur të identifikoj 1540 parcela komunale që janë në pronësi të komunës, por ende nuk ka arritur të regjistroj në regjistrin kontabël për shkak se pronat nuk kanë vlerë financiare.

Kryetari i Komunës me datën 14.12.2015 kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare në pronësi të komunës për tri drejtoritë: administratë, shëndetësi dhe arsim. Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë komisioni duhej ta përfundonte punën deri në mbylljen e vitit fiskal në mënyrë që ndryshimet të harmonizohen me PVF-të e vitit 2015, mirëpo këto komisione ishin vonuar në kryerjen e punës. Komisioni i drejtorisë së arsimit e kishte kryer punën me vonesë me datën 23.03.2016, ai i administratës me datën 07.03.2016, ndërsa i shëndetësisë me datën 07.03.2016 dhe ndryshimet e identifikuar nuk kanë mundur të harmonizohen me PVF.

Komuna e Istogut nuk kishte kontrolle efektive për monitorimin dhe raportimin e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare. Automjetet janë shfrytëzuar nga zyrtarët e komunës pa e plotësuar dhe pa e miratuar formularin/kërkesën për përdorim të përkohshëm të automjetit zyrtarë. Përveç kësaj, çdo drejtues i automjetit ishte i obliguar që në formular/fletudhëtim të shënoj numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, emrat e personave që udhëtojnë, numrin e kilometrave në momentin e kthimit si dhe nënshkrimin e përdoruesve. Kishte raste që nuk ishte plotësuar fletudhëtimi si dhe në shumë raste mungonin informacionet e plota. Nuk ishte zbatuar në tërësi rregullorja e komunës për përdorimin e automjeteve zyrtare.

Rreziku

Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pasurive të cilat janë në pronësi të komunës rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive të komunës dhe paraqitjes jo të drejtë të vlerës së pasurisë. Po ashtu, mos raportimi i saktë mbi shfrytëzimin e automjeteve rritë rrezikun e keqdeklarimit të tyre, si pasojë mund të krijohen shpenzime të pa rregullta dhe humbje financiare.

Rekomandimi 14

Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar, dhe më pas, të gjitha pasuritë të prezantohen drejt në PVF. Të sigurojë se implementohen kontrolle adekuate për të siguruar që përdorimi i automjeteve menaxhohet për nevoja zyrtare.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Komuna nuk i kishte menaxhuar drejt llogarit e arkëtueshme. Në vazhdim po i paraqesim gjetjet tona për këtë llogari.

Çështja 14 - Menaxhimi i dobët i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

E gjetura

Për vitin 2015 llogaritë e arkëtueshme ishin 953,000€. Krahasuar me vitin paraprak (1,323,186€), del se ato janë zvogëluar, mirëpo neve nuk na janë ofruar ndonjë dëshmi për të treguar se si janë zvogëluar këto llogari andaj ne nuk mund të ofrojmë ndonjë siguri mbi saktësinë e këtyre llogarive. Po ashtu, 176,000€ si borxhe të mbetura nga taksa për ushtrimin e veprimtari biznesore dhe 7,120€ taksa për pije jo alkoolike nuk ishin përfshirë në PVF të vitit 2015.

Rreziku Mos raportimi i drejt i llogarive të arkëtueshme apo fshirja e këtyre llogarive nga PVF pa ndonjë dokument (vendim) që dëshmon për procedurat e faljes rritë rrezikun se keqkuptimit të pozitës financiare të komunës.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj se heqja se llogarive të arkëtueshme nga PVF do të bëhet konform kërkesave ligjore ku do të tregohen qartë procedurat dhe mënyrat e shlyerjes së tyre. Më tutje, llogaritë e arkëtueshme të prezantohen drejt në PVF.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 86,625€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Çështja 15 - Mos raportimi i obligimeve të papaguara në pajtim me rregulloren e thesarit - Prioritet i mesëm

E gjetura Edhe pse kishte qenë rekomandim i vitit të kaluar në raportin e ZAP që komuna t'i raportoj obligimet mujore sipas nenit 5 të rregullores 02/2013 në Ministrinë e Financave-Thesar, kjo nuk ishte bërë nga ana e komunës.

Rreziku Mos raportimi i obligimeve të papaguara rritë rrezikun që obligimet e komunës të mos pasqyrohen drejtë në PVF dhe vështirëson planifikimin e buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj që raportimi i obligimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore dhe të ndërmerr masa që faturat të paguhen brenda afateve ligjore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo te implementuar	Të pa adresuara
1. Rreziqet domethënëse në PVF	Kryetari duhet të siguroj që për financimet e projekteve të cilat bëhen nga donatorët e jashtëm, të mbahen të dhëna të plota në mënyrë që të prezantohen në PVF si pagesa nga palët e treta.			X
1.1 Rreziqet domethënëse në PVF	Kryetari duhet të analizojë arsyet për Theksim të Çështjes për vitin 2014 dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015.		Pjesërisht	
2. Procesi i përgatitjes së PVF	Kryetari duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2015 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			X
3.Rekomandimeve nga viti paraprakë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë një afat kohor konkret për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.		Pjesërisht	
4 Proceset e llogaridhënjesë	Kryetari duhet të siguroj që rishikimi është kryer për të përcaktuar formatin e raportimit financiar për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi rreziqet, dobësitë e kontrolleve dhe t'i menaxhojë ato në mënyrë aktive.			X

4.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 LMFP	Kryetari duhet të siguroj pagesën e faturave me kohë dhe të evitoj rrezikun që pagesat të ekzekutohen përmes vendimeve gjyqësore.		Pjesërisht	
4.2 Mbledhja e të hyrave	Kryetari duhet të siguroj një strategji duke i vendosur, specifikuar të gjitha masat dhe mekanizmat e duhur për inkasimin e borxheve të mbetura nga vitet e kaluara. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandëve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale.			X
4.3 Prokurimi-Dobësitë sistematike në prokurim	Kryetari duhet të siguroj se të mos vazhdohet asnjë kontratë kornizë dhe të respektoj kriteret sipas Dosjeve të Tenderit, në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE të përgjegjshëm; Përveç kësaj procedimi i shpenzimeve duhet të jetë klasifikuar dhe regjistruar në kodet adekuate.		Pjesërisht	
4.3.1 Pagesë për punët e pa përfunduara	Kryetari duhet të siguroj që rasti i kanalit të Gogës është rishqyrtuar dhe të analizohen pse dështimet në proces kanë ndodhur, shtoj kontrollet monitoruese për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen dhe ndërmer masa administrative aty ku nevojiten. Komisioni duhet të mbahet llogaridhënës dhe duhet të merren masa administrative.	X		
4.3.2.1 Dobësitë jo sistematike	Kryetari të siguroj që të mos bëjë investime në asete private dhe të respektoj kompetencat e tij konform Ligji të Vetëqeverisjes Lokale.	X		
4.3.2.2 Transfer i mjeteve në mungesë të aprovimit nga MF	Kryetari duhet të siguroj realizimin e projekteve sipas planifikimit të buxhetit dhe në rastet e bartjes së mjeteve prej një projekti në projekte tjera të zbatoj kornizën rregullative në fuqi.	X		

4.3 Kompensimet	Kryetari duhet të rishikoj çështjen e ngritjes së koeficienteve dhe të siguroj që në sistemin e pagave të mos figurojnë 16 udhëheqës të personelit. Veç kësaj, të siguroj që dosjet e personelit të mbahen edhe në formë elektronike.		Pjesërisht	
4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që mundësojnë regjistrimin sistematik të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës në pajtim me kërkesat e UA dhe raportimin e saktë dhe të plotë të pasurive. Po ashtu, në fund të çdo viti, të formoj komisionet me kohë dhe rezultatet e regjistrimit t'i azhurnoj në regjistrat e pasurisë.		Pjesërisht	
4.4.2 Trajtimi i llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për mbledhjen e të llogarive të arkëtueshme, duke i përcaktuar masat e qarta, afatet dhe personat përgjegjës për ekzekutimin e planit.			X
4.4.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj që raportimi i obligimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore dhe të ndërmer masa që faturat të paguhen brenda afateve ligjore.			X
4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj që përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NJAB-it të monitorohet çdo tre muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që auditimi i brendshëm të jetë më efektiv duke përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm. NJAB-i duhet të hartoj dhe të nënshkruaj statutin e auditimit të brendshëm.		Pjesërisht	